



Së bashku mund t'ia dalim



“Të rritet përkushtimi i komunitetit Rom dhe Egjiptian për t’u dhënë zë nevojave të tyre.”

– Projekt i Qendrës Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin në bashkëpunim me shoqatat:
Instituti i Kulturës Rome, Bashkimi Demokratik i Romëve,
si dhe Një Zë i Barabartë Rom e Egjiptian në Komunitetin Vlonjat.

nëntor 2016 - mars 2017, Tiranë

I. 1. Takim me Komisioneren për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokatin e Popullit - në faqen 2

I. 2. Takim me përfaqësues të Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Brendshme - në faqen 4

I. 3. Shfaqja teatrale “Kanellë” - në faqen 6

II.1. Origjina e Romëve - në faqen 7

II. 2. Dita Ndërkombëtare e Romëve - në faqen 8

III.1. Ligj Nr. 119/2014 për të Drejtën e Informimit - 9

I. VEPRIMTARITË

I.1. Takim me Komisioneren për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Avokatin e Popullit

Në muajin nëntor tetë përfaqësues të komunitetit rom dhe egjiptian nga Tirana dhe Vlora zhvilluan dy takime për të kërkuar mbështetjen ndaj çështjeve të tyre. Një takim u zhvillua me Komisioneren për Mbrojtjen nga Diskriminimi zonjën Irma Baraku dhe një tjetër me Avokatin e Popullit zotin Igli Totozani.

Qytetarët prezantuan nismën e tyre dhe veprimtaritë e ndërmarra (identifikimin e çështjeve, takimet me të zgjedhurit vendorë) dhe qëllimin e tyre për të realizuar një takim publik me të zgjedhurit dhe autoritetet vendore dhe qendrore për çështjet e regjistrimit civil, strehimit dhe një sërë prioritetesh lokale (Vlorë).





Znj. Irma Baraku, gjithashtu, i prezantoi pjesëmarrësit me punën e komisionerit për mbrojtjen e të drejtave të grupeve në nevojë dhe u premtoi se do të ishte mbështetëse e çështjeve të qytetarëve romë dhe egjiptianë dhe do të ngrinte zërin në rrugë institucionale për zgjidhjen e këtyre çështjeve.

Gjatë takimit me Avokatin e Popullit pjesëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian u njohën me përpjekjet e këtij institucioni për të përmirësuar jetën e minoriteteve në përgjithësi, si edhe të romëve dhe egjiptianëve në veçanti duke përfshirë:

- *Përmirësimin e skemës së strehimit nëpërmjet marrëveshjeve midis shtetit dhe ndërmarrjeve private për punësimin e këtij komuniteti;*
- *Rekomandimet për njohjen e minoritetit rom me ligj jo thjesht një minoritet gjuhësor;*
- *Rekomandimet për regjistrimin civil të këtyre komuniteteve duke bashkëpunuar me organizma ndërkombëtarë, etj.*

Ndërkohë Avokati u shpreh se do të vazhdojë të mbështesë këtë nismë të ndërmarrë nga qytetarët duke qenë pjesë e veprimtarive të tjera në kuadër të projektit.

Në muajin dhjetor një konferencë u mbajt nga Avokati i Popullit dhe një sërë institucionesh shtetërore dhe jo shtetërore ku avkoati gjatë fjalimit të tij i bëri thirrje qeverisë të konsiderojë rekomandimet e institucionit që ai përfaqëson lidhur me politikat e strehimit, regjistrimin civil etj. Aktivistë të projektit morën pjesë në konferencë u takuan dhe me përfaqësues të qeverisë dhe shtruan çështjet e tyre.





I.2. Takim me përfaqësues të Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Brendshme

Më 23 shkurt në mjediset e Hotel Diplomat Tiranë, 23 qytetarë romë dhe egjiptianë organizuan një takim publik me drejtoreshën e Drejtorisë së Strehimit dhe Mirëqenies Sociale pranë Bashkisë Tiranë, Anisa Ruseti dhe specialistin e Drejtorisë së Gjendjes Civile pranë Ministrisë së Brendshme z. Edmond Gjoleka. Ky takim u zhvillua për të diskutuar arritjet, sfidat dhe planet e këtyre institucioneve lidhur me çështjet e strehimit dhe regjistrimit civil të komunitetit rom dhe egjiptian. Moderatorët Brunilda Hylviu dhe Brisilda Taço prezantuan situatën e këtyre dy çështjeve në Tiranë duke iu referuar situatës konkrete, por edhe shifrave të bëra publike nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë në "Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020". Theksi u vu te kushtet e këqija të banimit të romëve dhe egjiptianëve; mungesa e instalimeve hidrosanitare të infrastrukturës, etj për arsye të varfërisë historike, mungesës së të ardhurave të punës dhe pamundësisë për të përballuar programet sociale të strehimit.

Lidhur me aksesin në regjistrin civil u nënvizua se romët dhe egjiptianët, hasin vështirësi dhe kanë probleme në lidhje me regjistrimin civil, sidomos fëmijët romë; mungon dokumentacioni i dhënë nga materniteti, për shkak të lindjes jashtë mjediseve shëndetësore. Për rrjedhojë, ata nuk përfitojnë nga shërbimet dhe programet vendore, si p.sh. strehimi social, shkollimi i fëmijëve, shëndetësia, etj.

Pyetjet kyçe drejtuar zyrtarëve ishin:

- *Cilat janë veprimtarite/politikat/arritjet dhe planet për të ardhmen për çështjet e strehimit dhe regjistrimit në regjistrin civil kombëtar të pjesëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian.*
- *Cilat janë programet e strehimit dhe të regjistrimit? A mund të përfitojnë të gjithë qytetarët romë dhe egjiptianë në nevojë nga këto programe?*

STREHIMI

Drejtoresha e DSMQ, znj, Ruseti i njohu të pranishmit me tre programet e mëdha të strehimit, që zbaton Bashkia e Tiranës:

Programin e kredive të buta, atë të bonusit të strehimit (subvencionimi i qirasë së banesës) dhe programin e banesave sociale.



“Ka mes nesh romë apo egjiptianë që vuajnë për bukën e gojës; nuk kemi punë as shtëpi; banesat sociale nuk i paguajmë dot; qeveria duhet të mendojë për këtë – u shpreh një nga pjesëmarrësit Selmani”.

Sipas Rusetit 400 familje kanë përfituar bonusin e strehimit (familje rome dhe egjiptiane kanë pasur prioritet); ndërkohë znj. Ruseti u bëri me dije të pranishmëve se falë përpjekjeve të shoqërisë civile duke përfshirë edhe këtë nismë, si edhe vullnetit të mirë të qeverisjes vendore, është marrë vendimi që bonusi i strehimit, që përfundon në mars të vitit 2017 (ka filluar në 2015), do të shtyhet edhe një vit duke ua ofruar qytetarëve pa kontratë të noterizuar për t’i dhënë mundësi familjeve në nevojë të marrin masat për të përmirësuar situatën e tyre ekonomike, por pas një viti do të kërkohet një kontratë e noterizuar

Ndërkohë janë ndërmarrë dy ndërhyrje strategjike: 60 banesa sociale do të ndërtohen brenda gjashtë muajve (që nga muaji shkurt) në Shkozë dhe 60 banesa të tjera për banorë të Bregut të Lumit, të cilët janë vendosur në banesa tranzitore, meqë u rrezikohet jeta nga erozioni i tokës.

Në fjalën e saj drejtoresha theksoi se romët dhe egjiptianët kanë qenë në fokus të këtyre programeve. Psh nga 177 banesa sociale të ofruara për shtresat në nevojë 100 janë përfituar nga këto komunitete. Ndërkohë janë shfaqur edhe problematika të shumta ku rreth 100 familje nuk paguajnë rregullisht qiratë e banesave sociale, apo ka pasur raste që të rinjve romë u është ofruar punë për të lehtësuar situatën e jetesës, por nuk kanë shkuar të punojnë.

AKSESI NË REGJISTRIN CIVIL

Z. Gjoleka, përfaqësues i Ministrisë së Brendshme tha se në 2016 falë punës së mirë të institucionit që ai përfaqëson janë regjistruar 192 fëmijë romë dhe egjiptianë. Falë edhe ndërhyrjeve në sistemin shëndetësor (regjistri i vaksinimit) dhe, marrjes së të dhënave të sakta të mëmësisë, janë ulur rastet e mosregjistrimit nga këto komunitete. Ministria e Brendshme ka bashkëpunuar me Institutin European të Tiranës (TILAS) për të kryer regjistrimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë ndërkohë që kanë hasur vështirësi për fëmijët, që vijnë nga jashtë p.sh. pala greke nuk është treguar shumë bashkëpunuese.

Sipas zotit Gjoleka edhe qytetarët duhet të bashkëpunojnë, sepse duhet të shkojnë vetë



pranë zyrave të gjendjes civile të regjistrohen meqë praktikisht/teknikisht nuk është e mundur të arrihen të gjitha rastet. Partnerë ndërkombëtarë të rëndësishëm po përfshihen në planet e Ministrisë së Brendshme.

Pyetjeve të tilla si a janë verifikuar programet sociale apo ka shteti programe zbutëse sociale që qytetarët romë dhe egjiptianë të përballojnë qiratë e banesave sociale, zyrtarët iu përgjigjën por pa dhënë hollësi konkrete.

Në planin kombëtar të MMSR specifikohet mjaft qartë sesi mund të adresohen këto çështje, por zbatimi i këtij plani do të kërkojë një vullnet të mirë politik, si dhe angazhimin e të gjithë aktorëve me qëllimin që programet sociale të strehimit të ndërthuren praktikisht me programet e punësimit.

Ky takim publik u mbulua nga televizioni In dhe u transmetua në edicionin qendror të lajmeve të mbrëmjes të këtij televizioni.

I.3. Shfaqja teatrale “Kanellë”

Aktivistë të Qendrës Po, aktorë të Universitetit të Arteve të Tiranës në bashkëpunim me të rinj nga komuniteti rom dhe egjiptian punuan së bashku për të realizuar shfaqjen teatrale “Kanellë”. Shfaqja u vu në skenë më 9 mars, në sallën e e Qendrës Kulturore të Tiranës (Teatri Metropol) dhe u ndoq nga 150 të rinj, prindër, mësues dhe bashkëpunëtorë të QSHPZH-së

Përmes lojës së shkëlqyer të aktorëve, humorit dhe gjuhës së aritkuluar, shfaqja tregoi se nëse dashuria është e fortë ajo mund të kalojë të gjitha pengesat që hasin dy të rinj me përkatësi të ndryshme etnike. Shfaqja percolli mesazhin e rëndësishëm të edukimit tek njerëzit të vlerave si: toleranca, respekti, mosdiskriminimi ndaj njëri-tjetrit për një jetë të paqte, më të gezueshme dhe për një realitet që përmbush potencialet e të gjithëve.

Teatri u mirëprit nga të gjithë shikuesit, të cilët bënë komente tepër

pozitive për mesazhet e rëndësishme që u përcollën. Më pas ky aktivitet u publikua në FB e qendrës Po duke arritur me mesazhe pozitive 1800 persona të tjerë.



Një shfaqje e mrekullueshme mjaft edukative; depërtoi në mendjet dhe në zemrat tona - Mari Isuf.

Loja e shkëlqyer e aktorëve na emocionoi, por edhe na tregoi se nëse vajzat janë të mirëedukuara ato mund të arrijnë atë ç'ka duan, madje me fuqinë e tyre mund t'u japin mësim mbi vlerat e respektit dhe mosdiskriminimit të gjithëve – Andi Rabiaj .





II. ORIGJINA DHE HISTORIA E ROMËVE

II.1. Origjina e Romëve

Romët e Europës janë minoriteti etnik më i madh në Europë, duke numëruar më shumë se 10 milion njerëz të përhapur anembanë kontinentit. Romët kanë një kulturë dhe gjuhë unike ndryshe nga fqinjët e tyre jo romë, duke treguar për një origjinë, që përgjithësisht i ka rrënjët në Azinë jugore. Megjithatë ka pak informacion për historinë e thellë dhe ngjarjet, që ndodhën gjatë migrimit të tyre nga India përmes Persisë, Armenisë, Turqisë për në Ballkan dhe shpërndarjen e tyre përmes Europës.

Për të mësuar më shumë rreth romëve të Europës studiuesi David Coma dhe skuadra e tij punuan me 753 romë dhe 984 jo romë për të kuptuar më mirë ndikimin gjenetik të kësaj popullate te genet e europianëve. Studimi u zhvillua për disa vite në Greqi, Bullgari, Rumani, Hungari, Sllovaki, Ukrainë dhe Spanjë. Rezultatet e fundit zbuluan shkëmbime të meshkujve dhe femrave ndër breza nga europianët jo romë tek romët dhe shumë më pak shkëmbime në drejtim të kundërt.

Romët fillimisht ngatërroheshin me "ciganët" në shekullin e 16-të, sepse ky grup njerëzish fillimisht u mendua se vinte nga Egjipti. Në ditët e sotme shumë e konsiderojnë fjalën "cigan" si ofenduese.

Me hyrjen e teknologjisë gjenetike, studiuesit kanë analizuar historinë gjenetike të pjesës më të madhe të kombeve të Europës. "Por megjithëse janë 11 milion romë, që jetojnë në Europë historia e tyre është neglizhuar",- thotë studiuesi David Comas i Institutit të Biologjisë Evolutive në Universitetin e Fabra Pompeut në Francë.

Historia linguistike, gjithashtu edhe disa studime të kufizuara, sugjerojnë se romanët e kanë prejardhjen nga India rreth 1500 vite më parë. Për të konfirmuar këtë ide dhe për të zbuluar më shumë detaje mbi emigrimin, Coma dhe bashkëpunëtorët e tij përdorën një teknikë që krahason segmentet e ADN-së përmes tërë genomit me atë të pjesës tjetër të popullatës. Ata përdorën kampione të ADN-së së 13 grupeve të romanëve në të gjithë Europën.

Rezultatet zbuluan se paraardhësit e romëve modernë migruan nga veriperëndimi i Indisë rreth 1500 vite më parë, raportojnë Comas dhe kolegët e tij në ditët e sotme.

"Sapo arritën në Europë, ata u përhapën në të gjithë kontinentin nga Ballkani rreth 900 vite më parë", - tha Comas.

Ndër shekuj martestat e ndërsjella mes romëve dhe popullsisë lokale kanë njohur ulje dhe ngritje. Shpesh ata janë diskriminuar; gjatë Holokaustit rreth 200000 dhe 1.5 milion romë u vranë nga Hitleri. Pas Luftës së Dytë Botërore, romët në vendet komuniste u shënjestruan shpesh për zhdukje që shpesh nënkuptonin sterilizim të sforcuar për të zvogëluar shkallën e lindjes ndërmjet tyre.

Materiali u përshtat nga Live science

II.2 Dita Ndërkombëtare e Romëve

Dita Ndërkombëtare e Romëve është një kremtim i historisë rome, i traditave dhe kulturës së tyre, por edhe thirrje për përfshirje sociale. Kjo ditë synon, gjithashtu, të rrisë ndërgjegjësimin mbi sfidat me të cilat përballen komunitetet rome në të gjithë botën.

Kjo ditë është deklaruar zyrtarisht në vitin 1990 në Poloni, gjatë kongresit të katërt të Unionit Ndërkombëtar Rom, në nderim të takimit të parë ndërkombëtar të përfaqësuesve romë mbajtur në prill të vitit 1971.

Flamuri rom është flamuri ndërkombëtar i romëve. Ai është krijuar nga Unioni i Përgjithshëm i Romëve në Rumani në vitin 1933 dhe u miratua nga përfaqësuesit ndërkombëtarë romë në vitin 1971.

Ngjyra blu simbolizon qiellin, ndërsa jeshilja përfaqëson tokën dhe të korrat. Flamuri mban, gjithashtu, një rrotë të kuqe (chakra) në kujtim të origjinës indiane të Romëve, e cila simbolizon zjarrin, lëvizjen dhe progresin.

Romët kanë zhvilluar traditat e tyre në muzikë, poezi, kërcim dhe pikturë. Muzika tradicionale rome është ndoshta pjesa më e njohur e kulturës rome. Muzika e tyre ka influencuar kompozitorët e muzikës klasike të tillë si Franz Liszt dhe Johannes Brahams. Violina, kitara dhe klarineta janë instrumentet e preferuara të muzikantëve romë.

Kërcimi tradicional është një tjetër element i rëndësishëm i kulturës rome. Ai ka ruajtur elemente nga India, ashtu siç edhe ka përfshirë elemente nga kultura e vendeve në të cilat Romët kanë jetuar. Kërcimi Flamengo përfaqëson ndoshta shembullin më të dukshëm të kontributit të Romëve në stilin e përgjithshëm të kërcimeve.

Gjuha rome është ruajtur mirë dhe flitet në të gjithë botën në dialekte të ndryshme. Vitet e fundit shumë studiues kanë punuar për ta standardizuar gjuhën rome duke prodhuar abetare dhe fjalorë.

Analizat gjuhësore kanë treguar se ajo është shumë e ngjashme me gjuhët e folura në Indinë qendrore dhe veriore dhe kjo lidhje gjuhësore besohet se dëshmon origjinën gjeografike të romëve.

Romët kanë shkëlqyer edhe në punimet artizanale si në punimin e metalit, qëndisjen dhe gdhendjen e bizhuterive.

Shportat e kashtës të punuara me dorë janë një tjetër produkt tipik i romëve.

Veshjet tradicionale përdoren akoma gjerësisht në disa komunitete rome, ku gratë veshin fund të gjatë të lidhur në të majtë të belit, një bluzë dekolte, një jelek bolero, një përparëse dhe vathë me ngjyra.

Në ditën ndërkombëtare të romëve organizatat e shoqërisë civile kryesisht rome mblidhen së bashku për t'u bërë thirrje vendimmarrësve për më shumë vëmendje ndaj romëve. Një fushatë e tillë do të zhvillohet edhe këtë vit, ku aktivistët edhe zbatuesit e projektit do të bëjnë thirrje për zgjidhjen e çështjes së strehimit dhe të regjistrimit civil.

III. TË NJOHIM TË DREJTAT TONA

LIGJ Nr. 119/2014 PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Neni 7

Kategoritë e informacionit, që bëhet publik pa kërkesë:

- a) Një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;
- b) Tekstet e plota: i) të konventave, që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; ii) të ligjeve; iii) të akteve nënligjore; iv) të kodeve të sjelljes; v) të çdo dokumenti politikash; vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër, që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë;
- c) Informacion për procedurat, që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- ç) Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- d) Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- dh) Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit, që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet, që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- e) Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit.
Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet, që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;
- ë) Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
- f) Informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;

- g) Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;
- gj) Çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;
- h) Një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit, që bëhet publik pa kërkesë;
- i) Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji;
- j) Një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato; k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;
- l) Çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik.

Neni 11

Kërkesa për informim

1. Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij. Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, të parashikuar në nenin 8 të këtij ligji.
2. Në çdo rast, kërkesa për informim regjistrohet dhe për të caktohet një numër rendor. Numri rendor, së bashku me të dhënat e kontaktit të koordinatorit për të drejtën e informimit, i jepet kërkuarit që ka bërë kërkesën për informim.
3. Kërkesat për informim regjistrohen sipas radhës së paraqitjes dhe trajtohen pa dallime mes tyre.
4. Kërkesa për informim duhet të përmbajë: a) emrin dhe mbiemrin e kërkuarit; b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni; c) përshkrimin e informacionit që kërkohet; ç) formatin në të cilin preferohet informacioni; d) çdo të dhënë që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.
5. Në qoftë se kërkesa për informim nuk e përcakton formatin në të cilin kërkohet informacioni, ai jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.

Neni 12

Saktësimi dhe trajtimi i kërkesës për informim

1. Në rastet kur autoriteti publik, të cilit i drejtohet kërkesa për informim, është i paqartë në lidhje me përmbajtjen dhe natyrën e kërkesës, ai kontakton menjëherë, por gjithnjë jo më vonë se 48 orë nga data e paraqitjes së kërkesës, me kërkuarin për të bërë sqarimet e nevojshme. Në çdo rast, autoriteti publik ndihmon kërkuarin në

saktësimin e kërkesës.

Neni 13

Kostoja e shërbimit

1. Shërbimet e administratës publike janë pa pagesë. Dhënia e informacionit mund të bëhet kundrejt një tarife, të përcaktuar më parë dhe të bërë publike nga autoriteti publik në faqen e tij të internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut. Tarifa është kostoja e riprodhimit të informacionit të kërkuar dhe, kur është rasti, e dërgimit të tij. Informacioni i kërkuar në rrugë elektronike jepet falas.

Neni 14

Mënyrat e dhënies së informacionit

1. Të gjitha kërkesat për informacion trajtohen, si rregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.
2. Kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuarit: a) një kopje të plotë, në format të njëjtë me atë të përdorur nga autoriteti publik, përveç rasteve të veçanta; b) një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet.
3. Lidhur me kërkesat, që lidhen me forma të tjera, informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.
4. Në çdo rast, vendimi i refuzimit për formën e kërkuar jepet me shkrim dhe i arsyetuar.

Neni 15

Afati për marrjen e informacionit

1. Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.
2. Kur autoriteti publik që merr kërkesën për informim ia dërgon atë një autoriteti tjetër, ai kthen përgjigje jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë.
3. Afati i parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, mund të zgjatet me jo më shumë se 5 ditë pune për shkaqet e përcaktuara në ligj.

Ky ligj parashikon edhe saknsikone për shkeljet administrative gjoba nga 50.000 lekë deri në 300.000, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.

Së bashku mund t'ia dalim

Të gjithë ju qytetarë që doni të bashkoheni me ne në këtë nismë apo dëshironi të informoheni më tej, mund të na kontaktoni në adresat e mëposhtme:



Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin

Bulevardi: "Gjergj Fishta",
Kompleksi "Tirana 2000", Kulla VIII, Kati II, Tiranë, Shqipëri
Tel/Fax: +355 (42) 251 475; Email: info@acpd-al.org



Qendra AULONA

L. "29 Nëntori", Përballë Bibliotekës së qytetit
Çerdhja 15, Kati II, Vlorë, Shqipëri
Telefon: +355 (33) 2 24531; Email: aulona.center@gmail.com
web: acpd.org.al



Embassy of the United States of America
Tirana, Albania

Ky material është pjesë e projektit që mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-se në Tiranë. Opinione, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autor-it/ve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.